



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 20

Datë: 21. 07. 2022. Ora: 13: 00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Alim Rama, Arianit Elshani, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjes Nr.17 dhe 18-2022.**
- 3. Aktivitetet e ZRPPC-së:**
- 4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**
 - **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i realizimi të Planit të Punës së KQZ-së për periudhën janar- qershor 2022.
 - Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të Planit të Punës të KQZ-së 2022.
 - **Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

- Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për aplikim të KQZ-së, për postin e Zëvendës Kryesuesit të AËEB-it.
- Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në Konferencën e 19-të Evropiane e Trupave të Menaxhimit të Zgjedhjeve me temën: “Inteligjenca artificiale dhe integriteti i zgjedhjeve”.
- Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Letoni që, mbahen më 1 tetor 2022, dhe pjesëmarrja në aplikimi të KQZ-së për postin e Zëvendëskryesuesit.

Të ndryshme !

Hulumtimi dhe analiza e Fletëvotimeve

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së e hapi bledhjen dhe paraqiti pikat e rendit të ditës. Pas kësaj, u miratuan procesverbalet (me vërejtje të z. Alim Rama) nr. 17 dhe 18/2022.

Kreshnik Radoniqi, në vazhdim të mbledhjes e informoi KQZ-në lidhur me takimin me kryesuesin e OSBE-së në selinë e KQZ-së. Ka qenë një takim i shkurtër, një takim protokolar me qëllim të njoftimit, si dhe jemi njoftuar për veprimtarisë së OSBE-së në rajon, shtrjet dhe investimet e tyre. Po ashtu, edhe ne e informuam kryesuesin e ri me raportet tona, me bashkëpunimin dhe ndihmen e vazhdueshme që OSEB ka dhënë për KQZ –në, sidomos në proceset zgjedhore. Të dy palët konstatuam se Kosova është e pavarur, mirëpo bashkëpunimi reciprok vazhdon, përkrahja...

2. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i realizimi të Planit të Punës së KQZ-së për periudhën janar- qershor 2022:

Arianit Elshani, kryesues i këshillit tha se KOZ ka shqyrtuar realizmin e planit të punës së KQZ-së në periudhën janar – qershor të cilin edhe e kemi miratuar si KQZ, dhe nga 57 aktivitete të planifikuara, 52 prej kanë qenë të planifikuar që të filllojnë; nga 23 aktivitete të parapara brenda këtij gjashtë mujori, 19 aktivitete janë realizuar plotësisht, dhe katër aktivitete janë në realizim e sipër. Gjatë kësaj

periudhe, është realizuar edhe aktiviteti “Strategjia e Listës Votuese”, e që ishte planifikuar të përfundohet deri në shtator. Në tërësi, janë përfunduar 20 aktivitete, ose 83 % e aktiviteteve të planifikuara gjatë kësaj periudhe...

Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të Planit të Punës të KQZ-së 2022:

Arianit Elshani, tha se gjithashtu është shqyrtuar edhe rishikimi i planit të punës së KQZ-së, dhe janë të specifikuar në kuadër të raportit të gjitha aktivitetet me arsyetimet, përshkrimet dhe si KOZ e kemi vlerësuar pozitivisht punën...

Cështja e rregullave, ka qenë një punë më vete dhe ne, kemi kërkuar kohë më shumë mirëpo, pavarësisht sfidave, ne e kemi vlerësuar pozitivisht këtë realizim. Ky raport, është miratuar në KOZ me katër vota për, edhe një kundër...

Ne, rekomandojmë për miratim...

Në vazhdim, **Alim Rama** mori fjalën dhe tha se nëse e shohim me pëqindje realizimin e planit të Punës së KQZ-së për periudhën gjashtëmujore janar- qershor, mirëpo nëse e shohim nga aspekti kualitativ...Unë, prej fillimit i kam dhënë prioritet aktiviteteve që janë zhvillimore, që kanë të bëjnë me analizat; kjo ndërlidhet më shumë me diskutimin që kemi pas për strategjinë, dhe disa aktivitete që janë lënë në shtator ose në tetor ndoshta edhe janë planifikuar keq, por duhet të përfundojnë para se të mbyllen diskutimet për objektivat strategjike...

Unë ndërlidhen me aktivitetin që kishte të bëjë me “trendet zgjedhore”, e që kërkon me u shtye deri në gusht os shtator, e ky aktivitet është shty por është dashur me u përfundue me kohë; Për ne, është me rëndësi janë dy tri çështje që na informojnë për strategjinë...

Kam një kërkesë që duhet me u ndryshu: ma parë në planifikimi ka qenë strategjia e trajnimeve, por që aktiviteti duhet me u krye me kohë...Unë e kuptoj se disa në Sekretariat, edhe munden mos me i krye detyrat, por të tjerët munden me i krye; Unë mendoj se nëse nuk e kemi planin e punës si bazë për vlerësim, e duhet të jetë plani i punës si vlerësim...Ndoshta, edhe ne kemi dobësitë por, ne edhe nuk kemi përvojë por, Sekretariati është trup profesionale dhe obligimet duhet me u krye...

Unë, tha z. Rama, mendoj që duhet me u krye në fund të gushtit strategjia sepse është një element bazë që ne na duhet...

Sami Hamiti: E kemi diskutue gjatë në KOZ ! Dy elemnte janë: trendet zgjedhore që janë bërë dhe janë publikue kanë qenë shumë të vlefshme, pra duhet me u ba një dokument i mirë sepse trendet janë të rëndësishme shumë; madje edhe për partitë dhe shoqërinë civile...Ma mirë është të shtyhet afati, por besoj deri në shtator kryhen, s’kemi me humbë shumë kohë por, konsideroj me lanë kohë që dokumenti të bëhet mirë...S’konsideroj që është humbje, por deri sa ne ti bëjmë shtyllat shtrategjike gjithqysh, të bëhet...

Në këtë pikë, diskutuan edhe **Arianit Elshani**, i cili shpjegoi edhe disa aktivitete që duhen të zgjaten deri në shtator: 2 nga sekretariati, dhe 2 nga KQZ... Kosiderojmë që mund ta përmbushim planin brenda vitit, meqë janë 7 aktivitete që duhet me u shtye...dhe unë besoj se do të kryhen...

Në fund, anëtarët e KQZ-së miratuan periudhën e realizimit të planit të punës së KQZ-së janar- qershor 2022 me 7 vota për, dhe me 2 vota abstenim ! Dhe po ashtu, miratuan edhe rishikimin e Planit të Punës të KQZ-së 2022 me, 7 vota për, dhe me 2 vota abstenim.

Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

Kreshnik Radoniqi, tha se në KMJ janë shqyrtuar tri pika: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për aplikim të KQZ-së, për postin e Zëvendës Kryesuesit të AËEB-it. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në Konferencën e 19-të Evropiane e Trupave të Menaxhimit të Zgjedhjeve me temën: “Inteligjenca artificiale dhe integriteti i zgjedhjeve”. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i pjesëmarrjes së KQZ-së në vëzhgimin e Zgjedhjeve Parlamentare në Letoni që, mbahen më 1 tetor 2022, dhe pjesëmarrja në aplkimi të KQZ-së për postin e Zëvendëskryesuesit.

Në pikën e parë, jemi pajtuar për aplikim nag KQZ-së për postin e Zëvendës Kryesuesit të AËEB-it. Na është dërguar një kërkesë që edhe ne të shprehim interesim, pra kërkesa është dërguar si krejt anëtarëve... Ai që zgjidhet në këtë post, mbas dy vite koferenca mbahet në vendin prej nga vjenë zëvendëskryesuesi...

Jemi pajtuar tha z. Radoniqi që një delegacion i KQZ me marrë pjesë në takimin – konferencën e 5 – të që do të mbahet në Keptaun, në Afriken e Jugut. Sot, na është dërguar edhe imelli që ky takim mbahet në tetor, prej datës 17 – 22 tetor.

Nuk kemi diskutuar se kush shkon, dhe sa veta marrim pjesë.

Arianit Elshani, pyeti se si shkon mënyra e votimit, mënyra e përzgjedhjes për shkak të mundësive të lobimit, nëse vendosim për konkurim...

Kreshnik Radoniqi, tha se për informata më të detajuara duhet ta kontaktojmë sekretariatit e AËEB-it. Ne, jemi marrë vesh që të aplikojmë...

Sami Kurteshi: Po, kemi diskutuar për të aplikuar, por edhe nëse ndodh edhe ta organizojmë konferencën...Jam që, të shkojmë por, 2 veta jo më shumë...

Të njëjtin mendim, e shprehu edhe **Alim Rama**, sepse kjo tha është e mirë edhe për vendin ! Në këtë pikë, diskutuan edhe: Sami Hamiti, Rifat Krasniq, Sami Kurteshi, Alim Rama.

Burim Ahmetaj, në diskutimin e tij i informoi anëtarët e KQZ për agjenden vjeshtore. Ai tha se, konferenca e radhës për ACEEEO nuk është e definuar, por pritet të mbahet në tetor apo nëntor, por do të mbahet...KQZ, është mirë që të marrë pjesë...

Po ashtu, janë zgjedhjet në Letoni, dhe KQZ është mrië të marrë pjesë, t'i vëzhgoj ato ...

Më 14-15 nëntor është konferenca vjetore e Komisionit të Venecias...

Prej 17 – 22 tetor, pra është konferenca e AWEB-it...

Është edhe një trajnim ku do jenë edhe të gjithë anëtarët e KQZ-së që e organizon OSBE, por ende s'është e përcaktuar. Kjo, mbahet në Bruksel...

Kreshnik Radoniqi: AËEB, është prej 17 – 22 tetor. Komisioni i Venecias, është dy ditë përpara! Unë, këtu nuk marrë pjesë...

Delegacioni që shkon në Srasburg, dhe Letoni. Përcaktohuni...

Arianit Elshani, në Letoni ndoshta është mirë të ketë një përbërje më të madhe, se edhe sekretariati të marr pjesë...

Në këtë pikë, diskutoi edhe Gordana Laban, Sami Hamiti, Kreshnik Radoniqi etj.

Krejt në fund të debatit dhe propozimeve, KQZ mori këto vendime:

1. **Në Afrikën e Jugut, udhëtojnë**: Kreshnik Radoniqi, Alim Rama, Gordana Llaban dhe nga Sekretariati, Burim Ahmetaj. (Vendimi nr. 947/2022).

2. **Në Strasburg, udhëtojnë:** Kreshnik Radoniqi, Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Fazli Stollaj, dhe nga Sekretariati, Burim Ahmetaj. (Vendimi 948/2022)

3. **Në Letoni, udhëtojnë:** Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Arianit Elshani, Rifat Krasniq, Nexhmedin Hyseni, Kreshnik spahiu, dhe Valbona Kida. (Vendimi 949/2022)

Të ndryshme !

Për KQZ

Kreshnik Radoniqi, kryetar
